

# **RELACION I PROJEKTIT:**

## **Hapesire rekreative,park i qytetit Shijak**

### **1. Vendodhja**

Kufijte e zones se nderhyrjes urbane jane rruget ekzistuese dhe ndertimet informale ne very dhe ne jug. Siperfaqja totale e zones se studiuar eshte 4300 m<sup>2</sup>.

### **2. Pershkrimi i gjendjes ekzistuese**

Sot kjo zone eshte pjese e shkolles dhe ka akses vetem nga nxenesit. Gjithsesi nuk ofron kushtet minimale te hapsirave rekreative. Godina e shkolles eshte ne degradim te pote dhe eshte kthyer ne rrezik per nxenesit keshtu qe me ndertimin e shkolles se re kjo godine del jashte funksionit. Toka rrethohet nga dy ane nga ndertim te ulta informale dhe ka akses nga dy rruget qe e rrethojne. Ka nje pjerresi shum te lehte gjate shtrirjes se saje



### **3. Pershkrimi i konceptit urbanistik**

Projekti i "Hapsire rekreative, Park prane shkolles "Muharrem Dollaku" transmeton impuls te ri zhvillimi urban per qytetin e Shijakut. Projekti shnderron nje hapsire te harruar ne atraksionin kryesor te qytetit duke shtuar hapsirat e gjelbera duke ruajtur pemet ekzistuese dhe duke shtuar te reja.



Formulimi I ri krijon nje pershkrueshmeri te zones duke krijuar akses nga rruget kryesore qe e rrethojne parkun. Pike shume e rendesishme eshte dhe krijimi I hapsirave te rekreacionit si stolat e perbashket dhe pikat e takimit.

Koncepti qendron ne krijimin e nje pasazhi kryesor ne mes te gjelberimit I cili degezohet me nje hapsire qendrimi te qete dhe kendin e lojrave per femijet, ne fund ky pasazh perfundon me nje anfiteater I cili sherben si pike grumbullimi dhe per organizimin e eventeve te ndryshme.

Gjate te gjithe pasazhit te kalimit formohen disa stola me beton me ngjyre te cilet shkrihen md gjelberimin dhe ne disa pika dalin duke ofruar mundesi per tu ulur



Zona ne kushtet ekzistuese eshte nje zone pa funksionalitet dhe pothuaj e papardorshme nga qytetaret me perjashtim te nxenesve.. Per rrjedhoje, projekti perpiqet te nderhyje pikerisht te rifunksionalizimi i tij, per ta bere sa me te prekshem per ata qe do jene edhe protagonistet e tij qytetaret. Ne kete kontekst, hapsira rikonceptohet ne hapesira me te vogla qe do te mundesonin "relativizimin" e madheshtise se zones ekzistues ne shkembim te funksionalizimit te tij me hapesira "me te vogla" dhe me te prekshme per njerezit, futjen e gjelberimit ne trajte parku si pjese perberese si edhe elemente te mobilimit urban dhe lojra per grupmosha te ndryshme te femijeve.



Projekti parashikon shtrimin e pasazheve te parkut me material betoni te trajtuar. Ndersa pista e bicikletave do jete me asfaltobeton me ngjyre duke krijuar nje atrakcion tjeter per kete park.



Persa I perket gjelberimit eshte menduar nje kombinim I gjelberimit te ulet dhe te larte dhe I ngjyrave te ndryshme te pemeve gjate vitit



**PISTACIA CHINENSIS**

**Ngjyra e gjethes:**  
E GJELBER , E VERDHE DHE  
E KUQE

**Lartesia MAX:**

20 m

**Gjelberimi:**

I PERHERSHEM

**A2**

Ark.Klaudio ONUZI